



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITETI "HAXHI ZEKA" PEJE	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No. <u>319</u>		Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>8</u>	
Data / Datum / Date: <u>13 / 02 / 2022</u> Pejë / Peë			

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**RREGULLORE PËR SISTEMIN E SIGURIMIT DHE VLERËSIMIT TË CILËSISË
NË UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" NË PEJË**

Në mbështetje të nenit 206 - 217 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka", Ligjit Nr.04/L-L037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Manualit të Agjencionit të Kosovës për Akreditim, Senati i Universitetit në mbledhjen e mbajtur me 27.12.2019 nxjerrë këtë Rregullore.

Neni 1 Qëllimi

Rregullorja ka për qëllim rregullimin e sistemit të sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë, përcaktimin e mekanizmave dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë, si dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të palëve të përfshira në këto procese të cilat kanë për qëllim arritjen e objektivave institucionale të Universitetit.

Sistemi i sigurimit të cilësisë në Universitetin Haxhi Zeka synon:

- Që proceset e sigurimit të cilësisë brenda universitetit të jenë aktivitete të rregullta që kontribuojnë në zhvillimin e kulturës së cilësisë brenda universitetit
- Që rezultatet e proceseve të sigurimit të cilësisë të shërbejnë si udhërrëfyes për vendimmarrje dhe planifikim strategjik të universitetit
- Të ndërgjegjësojë secilin pjesëtar të komunitetit akademik brenda universitetit për detyrat dhe obligimet e tyre karshi proceseve të sigurimit të cilësisë
- Përfshirjen në mënyrë aktive të komunitetit akademik në proceset e sigurimit të cilësisë sidomos stafit akademik, studentëve, industrisë dhe akterëve të tjerë
- Britjen e transparencës dhe kredibilitetit të proceseve të sigurimit të cilësisë

Neni 2 Fushat e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit

1. Fushat e sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në UHZ janë:
 - 1.1. Vet vlerësimi i vazhdueshëm në nivelin institucional dhe të programeve të studimit;
 - 1.2. Hartimi dhe miratimi i programeve të reja të studimit;
 - 1.3. Rishikimi i programeve ekzistuese të studimit;
 - 1.4. Vlerësimi i procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe artistik, administratës, stafit akademik dhe gjitha fushave të tjera të veprimtarisë së Universitetit;
 - 1.5. Monitorim i vazhdueshëm dhe auditim periodik i programeve të studimit;
 - 1.6. Sigurimi periodik i cilësisë së jashtme;
 - 1.7. Mobiliteti, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërkombëtarizimi;
 - 1.8. Dhe fusha të tjera sipas nevojës apo kërkesave të ndryshme nga MASHT, Agjencia e Kosovës për Akreditim, etj.

Neni 3 Organet

1. Organet e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në UHZ, janë:
 - 1.1. Senati i UHZ-së;
 - 1.2. Rektori;
 - 1.3. Dekanët;
 - 1.4. Këshilli për Menaxhimin dhe Vlerësimin e Cilësisë (në tekstin e mëtejshëm: KMCV);
 - 1.5. Zyra për Cilësi dhe Vlerësim (në tekstin e mëtejshëm: Zyra);
 - 1.6. Komisionet (ad-hoc);
 - 1.7. Koordinatorët për Cilësi dhe Vlerësimin në njësi akademike.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e organeve nga neni 3 i kësaj rregullore, përpos kësaj rregullore janë të rregulluara edhe me akte tjera të Universitetit.
3. Organet nga neni 3, bashkëpunojnë me njëri tjetrin në zbatimin e procedurave të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë së Universitetit.

Neni 4

Senati

1. Senati është organi që miraton Rregulloren për Sistemin e Sigurimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në UHZ, Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë, Manualin e Sigurimit të Cilësisë, dhe emëron anëtarët e Këshillit të Menaxhimit të Cilësisë së Universitetit.
2. Senati miraton planin për realizimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, sipas propozimit të Këshillit Menaxhimit të Cilësisë.

Neni 5

Rektori

1. Rektori sigurohet që ekzistojnë kushtet e duhura për realizimin e aktiviteteve të vlerësimit brenda sistemit të sigurimit të cilësisë.
2. Rektori siguron mbështetjen e nevojshme financiare për të realizuar aktivitetet e vlerësimit brenda sistemit të sigurimit të cilësisë.
3. Rektori së bashku me pjesën tjetër të menaxhmentit siguron që rezultatet e vlerësimeve dhe masat e propozuara nga KMCV të i përkthejnë në masa operative për përmirësimet e duhura.

Neni 6

Këshilli i Menaxhimit të Cilësisë dhe Vlerësimit

KMCV është organ këshillues i Senatit dhe Rektorit, i cili në bashkëpunim me organe të tjera mbështetëse dhe profesionale të Universitetit nga neni 3 i kësaj Rregullore, planifikon, monitoron, analizon dhe administron procedurat e vlerësimit të procesit mësimor, hulumtimit shkencor, kërkimit artistik dhe gjitha vlerësimet e fushave të tjera që mbulohen nga universiteti.

Neni 7

1. KMCV në përbërjen e tij do të ketë dhjetë (10) anëtarë.
2. Anëtarët e KMCV do të propozohen si në vijim:
 - 2.1 Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të cilësisë (i përhershëm) – Kryesues;
 - 2.2 Pesë përfaqësues nga njësitë akademike të Universitetit (staf akademik), të cilët propozohen nga Këshilli i Njësisë Akademike;
 - 2.3 Drejtori i Zyrës për Cilësi dhe Vlerësim (i përhershëm) pa të drejtë vote;
 - 2.4 Zyrtari ligjor në nivel qendror (i përhershëm) pa të drejtë vote;
 - 2.5 Dy përfaqësues nga Studentët.

3. Anëtarët jo të përhershëm do të votohen nga Senati i Universitetit për një mandat 3 vjeçar, përveç përfaqësuesve të studentëve që zgjatë një (1) vit.
4. Së paku një e treta e anëtarëve të komisionit duhet të vazhdojnë në përbërjen e komisionit pas mandatit 3 vjeçar, për të siguruar vazhdimësinë e punës.
5. Në rast kur votimi është i barabartë, vota e kryesuesit është vendimtare.
6. KMCV harton dhe aprovon Rregulloren e Punës së këtij komisioni i cili është dokument publik i universitetit.
7. Komisioni për punën e vet i raporton Senatit.

Neni 8

1. Detyrat e Këshillit të Menaxhimit të Cilësisë së janë:
 - 1.1 I propozon Rektorit dhe Senatit një strategji me udhëzimet e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, kriteret, standardet dhe procedurat për realizimin e saj dhe përmirësimin e vazhdueshëm;
 - 1.2 Harton Manualin e Sigurimit të Cilësisë;
 - 1.3 Harton dhe aprovon planin e aktiviteteve për sigurimin e cilësisë në përputhje me rregullativën në fuqi dhe dokumentin strategjike të UHZ
 - 1.4 I dorëzon Rektorit dhe Senatit raport mbi planin e realizuar në aspektin e Sigurimit të cilësisë;
 - 1.5 I jep sugjerime Rektorit, Senatit, Komisioneve të njësive akademike, për përmirësim të nivelit të cilësisë;
 - 1.6 Inkurajon diskutimet për cilësinë dhe promovon kulturën e cilësisë brenda universitetit;
 - 1.7 Analizon të dhënat e mbledhura nga fushat e nenit 2 të kësaj Rregullore;
 - 1.8 Harton dhe i propozon Senatit aprovimin e raportit e vetëvlerësimit për Ri/Akreditim Institucional;
 - 1.9 Shqyrton dhe i propozon Senatit aprovimin e raporteve të vetëvlerësimit për Ri/Akreditim të Programeve të Studimit;
 - 1.10 Në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë dhe dekanët zgjedhë anëtarët e komisioneve ad-hoc për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës.
 - 1.11 Harton raporte të përmirësimit në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve të pranuar nga Zyra për Vlerësim dhe Sigurim të Cilësisë.
 - 1.12 Harton raporte të përmirësimit në bazë të vlerësimeve të Komisioneve ad hoc, të cilat bëjnë vlerësim të brendshëm periodik të programeve aktuale të studimit, dhe ia paraqet Këshillit të Njësive Akademike dhe Menaxhmentit të Lartë.
 - 1.13 Analizon dhe aprovon raportet periodike/vjetore dhe planet e veprimtarisë së sistemit të sigurimit të cilësisë së njësive akademike të Universitetit, të cilat raporte i dërgon tek Menaxhmenti i Lartë;

Neni 9

Zyra për Cilësi dhe Vlerësim

1. Zyra për Cilësi dhe Vlerësim është zyra qendrore e sigurimit të cilësisë në kuadër të Rektoratit të Universitetit.
2. Zyra për Cilësi dhe Vlerësim është zyre e pavarur e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë në kuadër të Universitetit e cila mbikëqyret nga Rektori.
3. Zyra për Cilësi dhe Vlerësim përbëhet nga:
 - a. Drejtori;
 - b. Zyrtari i Cilësisë dhe Vlerësimit;
 - c. Zyrtari për Akreditim.

4. Gjithashtu të gjitha njësitë akademike kanë nga një Koordinatorë të Cilësisë dhe Vlerësimit (pesë Koordinator)

Neni 10

1. Detyrat e Zyrës për Cilësi dhe Vlerësim janë:
 - 1.1 Zyra është mbështetës i KMCV-së në inicimin dhe koordinimin e iniciativave dhe në zbatimin e vazhdueshëm për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.
 - 1.2 Zyra organizon një monitorim sistematik të treguesve të miratuar të cilësisë, veçanërisht aktiviteteve si në vijim:
 - 1.2.1 Implementon Planin e Aktiviteteve të sigurimit të cilësisë të aprovuar nga KMSC,
 - 1.2.2 Mbledhë informacione për cilësi dhe vlerësim nga të gjithë akterët e sistemit brenda Universitetit,
 - 1.2.3 Në bashkëpunim me KMCV dhe Koordinatorët për Cilësi dhe Vlerësim organizon procesin e vlerësimit të brendshëm sipas Manualit për Sigurim të Cilësisë, përmes pyetësorëve dhe instrumenteve të tjera të parapara në Manual,
 - 1.2.4 Shpërndan pyetësorët, mbledh, përpunon dhe vlerëson të dhënat nga fushat e vlerësuara sipas nenit 2 të kësaj rregullore,
 - 1.2.5 Ofron mbështetje për Komisionet Ad Hoc në procesin e vlerësimit të ndryshimeve dhe plotësimeve në programet ekzistuese të studimit, si dhe në procedura të vlerësimit të brendshëm periodik.
 - 1.2.6 Ofron mbështetje administrative në procedurat e vlerësimit të brendshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë së Universitetit.
 - 1.2.7 I ofron mbështetje njësive akademike përmes Koordinatorëve për cilësi dhe vlerësim
 - 1.2.8 Mbledhë, përpunon dhe analizon të dhënat e nevojshme për përpilimin e raportit vjetor të punës
 - 1.2.9 Koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e Ri/Akreditimit institucional dhe të Ri/Akreditimit të programeve të studimit, bazuar në udhëzuesit dhe standardet e AKA-së,
 - 1.2.10 Mirëmban dhe i shqyrton dokumentacionin e procesit të ri/akreditimit, përgatitë raporte dhe analiza përkatëse.
2. Për përmbushjen e detyrave të përmendura në këtë nen të kësaj rregullore, Zyra bashkëpunon me të gjithë organet përgjegjëse për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në Universitetin nga neni 3 i kësaj rregullore.
3. Zyra vepron në përputhje me Planin Strategjik të UHZ-së, Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë, dhe Planin e aktiviteteve nga neni 8 i kësaj rregullore.

Neni 11

Dekanët

1. Dekanët e njësisë akademike sigurohen që ekzistojnë kushtet e duhura për realizimin me sukses dhe sipas planifikimit të aktiviteteve të vlerësimit brenda sistemit të sigurimit të cilësisë të njësisë akademike.
2. Dekani i njësisë siguron qasje në të dhënat për vlerësimet që bëhen në kuadër të kësaj rregullore.
3. Dekani i njësisë akademike zbaton planin e përmirësimit, sipas udhëzimeve të menaxhmentit, pas secilit aktivitet të vlerësimit dhe reflekton në përmirësimin e cilësisë.
4. Dekanët, sipas nevojës apo propozimit të KMCV-së, formojnë komisione ad-hoc, për vlerësime të cilësisë sipas nevojës së fushave të parapara nga neni 2.

Neni 12

Koordinatori për Cilësi dhe Vlerësim në njësi akademike të Universitetit

1. Koordinatori për Cilësi dhe Vlerësim do të ketë në të gjitha njësitë akademike të Universitetit.
2. Koordinatori për Cilësi dhe Vlerësim do të jetë Staf Akademik.
3. Koordinatori për Cilësi dhe Vlerësim do të implementoj aktivitetet e parapara në kalendarin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë dhe do të jetë në mbështetje të vazhdueshme të Zyrës së Cilësisë dhe Vlerësimit.
4. Koordinatori për Cilësi për punën e tij do të i raportoj Dekanit të Njesisë Akademike dhe Drejtorit të Zyrës së Cilësisë dhe Vlerësimit.
5. Detyrat e punës së Koordinatorëve për cilësi në njësi akademike do të parashihen me Udhëzuesin për Sigurim të Cilësisë.

Neni 13

Komisionet ad hoc

1. Komisionet ad hoc emërohen nga KVVC në koordinim me menaxhmentin dhe dekanët e njësive akademike.
2. Komisionet ad hoc përbëhen prej 7 anëtarëve, prej të cilëve,
 - 2.1. Tre nga stafi akademik,
 - 2.2. Dy përfaqësues të studentëve,
 - 2.3. Një përfaqësues i Bordit Industrial,
 - 2.4. Koordinator i Cilësisë dhe Vlerësimit në njësi akademike,
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve do të përcaktohen në vendimin e themelimit të Komisionit.

Neni 14

Llojet e vlerësimeve

1. Llojet e vlerësimeve në UHZ janë:
 - 1.1 Të Brendshme dhe
 - 1.2 Të jashtme
2. Vlerësimet e brendshme bëhen nga palët e brendshme dhe të jashtme, përmes studentëve, stafit akademik dhe stafit administrativ, punëdhënësve, alumni, apo ekspertët e jashtëm të angazhuar nga Universiteti.
3. Vlerësimet e jashtme bëhen nga autoritetet shtetërore të cilat me ligj njihen si autoritete të vlerësimit të jashtëm sikurse Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ose ndonjë agjenci tjetër ndërkombëtare e cila njihet sipas dispozitave të Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

Neni 14

Instrumentet për Vlerësim të brendshëm të Cilësisë

1. Vlerësimi i cilësisë së brendshme, bëhet përmes Pyetësorëve siç janë:
 - 1.1 Pyetësori - Dekani Mësimdhënësin;
 - 1.2 Pyetësori - Vetëvlerësimi i Stafit Akademik;
 - 1.3 Pyetësori - Studenti Mësimdhënësin;
 - 1.4 Pyetësori - Studenti Administratën;
 - 1.5 Pyetësori – Punëdhënësi;

- 1.6 Pyetësi - Të Diplomuarit (Alumni).
2. Vlerësimi i cilësisë së brendshme mund të bëhet edhe përmes formave të tjera, sikurse:
 - 2.1. Fokus grupet;
 - 2.2. Komisioneve ad hoc për vlerësimin e ndërmjetëm të programeve të studimit apo të fushave të tjera brenda Universitetit.
3. KMCV-ja është kompetent për përpilimin pyetësorëve të tjerë apo formave të tjera të vlerësimit ad-hoc që nuk janë përfshirë në këtë rregullore.

Neni 15

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë

1. Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet:
 - a. Me nismën e Këshillit Drejtues, Senatit ose Rektorit;
 - b. Me nismën e Këshillit të Njësisë Akadematike;
 - c. Me nismën e Ministrisë së Arsimit.
 - d. Sipas kohëzgjatjes së akreditimit nga AKA.
2. Të gjitha njësitë e Universitetit dhe organet e tyre janë të detyruara që në rast se kemi të bëjmë me vlerësim të jashtëm nga paragrafi 2 i këtij neni, të sigurojnë të dhënat e nevojshme dhe informatat për vlerësim dhe të bashkëpunojnë ngushtë me Organet e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në UHZ, nga neni 3 i kësaj Rregullore.

Neni 16

Afati/ Periudha e Vlerësimit

1. KMCV do të përpilojë kalendarin e aktiviteteve për proceset e sigurimit të cilësisë.
2. Mekanizmat institucional të paraparë si në nenin 3 të kësaj Rregullore janë përgjegjës për procesin e vlerësimit, dhe para se të bëhet vlerësimi i informojnë njësitë e universitetit, për:
 - 2.1 Fushat e vlerësimit;
 - 2.2 Procedurat dhe Oraret;
 - 2.3 Instrumentet.
3. KMCV, pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore do të hartojë Manualin për Sigurim të Cilësisë, në të cilin do të parashihen qartë mënyra, periudhat, forma e vlerësimit për të gjitha fushat e parapara si në nenin 2 të kësaj Rregullore.
4. Manuali për Sigurim të Cilësisë do të derivoj nga kjo rregullore.

Neni 17

1. Vlerësimi i Cilësisë do të bëhet përmes sistemit online dhe fizik për fushat e parapara në këtë rregullore.
2. Grumbullimi dhe ruajtja e të dhënave nga proceset të vlerësimit do të bëhen në databazën për cilësi në kuadër të UHZ-së.

Neni 18

Raportimi

1. Zyra mbledhë rezultatet e vlerësimit periodik/vjetor dhe planet e veprimtarisë së sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të njësisve akademike të Universitetit, dhe rezultatet e vlerësimeve i dërgon në KMCV.
2. KMCV është përgjegjës që pas pranimit të rezultateve të vlerësimeve nga Zyra të hartojë raportet përfundimtare të vlerësimit të cilat do t'ia prezantojë menaxhmentit të UHZ.
3. Raportet përfundimtare duhet të përmbajë:
 - 3.1 Procedurën e Vlerësimit;

- 3.2 Rezultatet e Vlerësimit;
- 3.3 Rekomandimet e propozuara;
- 3.4 Kohën e Implementimit të Rekomandimeve të Propozuara.
4. Pas pranimit të raportit nga menaxhmenti, Rektori do të kërkoj zbatimin e tij nga autoritetet drejtuese në nivel Universiteti, dhe në nivel të njëjsteve akademike sipas kornizës kohore të propozuar nga Këshilli.
5. Përmbledhjet e vlerësimeve në formë të raporteve do të publikohen përmes ueb faqes zyrtare të UHZ apo përmes kanaleve të tjera të brendshme të informimit të universitetit.

Neni 19
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja nr. ref. 293, e datës 19.02.2019, e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë dhe Rregullorja për Sigurim dhe Menaxhimin e Cilësisë nr. ref. 01-72/12, datë 04.10.2012.

Neni 20

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Senatin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Kryesuesi i Senatit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë



